



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 428 Prot.

Tiranë, më datë 13.05.2022

VENDIM
Nr. 151, datë 13.05.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 13.05.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raporti të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor, realizuar nga individ i licensuar në arkeologji, z. Lorenc Bejko në kuadër të projektit “Infrastrukturë Green Coast2”, me aplikues shoqëria “Manetci” sh.p.k. dhe zhvillues shoqëritë: “Green Coast” sh.p.k., “Seaside Residence II” sh.p.k., “Seaside Residence III” sh.p.k., “Seaside Residence IV” sh.p.k., “I&G” sh.p.k., “XH&M” sh.p.k., “Aqua Marin” sh.p.k., “Seaside Residence I” sh.p.k., “Devis Construction” sh.p.k., Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Edonil Konstruksion” sh.p.k dhe “Shamo Construction” sh.p.k.;
2. Gjatë procesit të zbatimit, sic parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr.27, datë 17.05.2018, “Për trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nga DRTK Vlorë ;
3. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

KRYETAR
Elva MARGARITI

